



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 22 nëntor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Pjetër Shalës për t'u liruar nga Seanca për Shqiptimin e Urdhrit për Zhdëmtim ose për Shtyrjen e Seancës

T'i dorëzohet:

Prokurores së Specializuar
Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së të akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Zyrës Administrative
Fidelma Donlon

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykses) lëshon këtë Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Pjetër Shalës (z. Shala) për ta liruar nga seanca për shqiptimin e Urdhrit për Zhdëmtim ose për të shtyrë seancën.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykses shqiptoi Aktgjykimin për këtë çështje gjyqësore.¹
2. Më 8 nëntor 2024, Trupi Gjykses caktoi datën për shqiptimin e Urdhrit për Zhdëmtim për më 29 nëntor 2024, në orën 11:00, në seancë publike (Urdhri për Caktimin e Datës). Trupi Gjykses urdhëroi z. Shala të ishte i pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit gjatë seancës.²
3. Më 15 nëntor 2024, Mbrojtja e z. Shala (Mbrojtja) dorëzoi kërkesën e vet për të liruar z. Shala nga seanca, ose, si alternativë, për të shtyrë seancën (Kërkesa e Mbrojtjes).³
4. Më 19 nëntor 2024, mbrojtësi i viktimave dorëzoi përgjigjen (Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave).⁴

¹ KSC-BC-2020-04, F00847, Trupi Gjykses I, *Aktgjykim dhe Dënim* (Aktgjykimi), 16 korrik 2024, konfidencial, me Shtojcën 1, publike. Versioni i redaktuar publik i Aktgjykimit u dorëzua më 24 shtator 2024, [F00847/RED](#).

² KSC-BC-2020-04, F00861, Trupi Gjykses I, *Urdhër për Caktimin e Datës për Shqiptimin e Urdhrit për Zhdëmtim*, 8 nëntor 2024, publik, para. 7, 8(a).

³ KSC-BC-2020-04, F00862, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes për ta Liruar z. nga Seanca për Shqiptimin e Urdhrit për Zhdëmtim, ose për Shtyrjen e Seancës*, 15 nëntor 2024, publik. Mbrojtja fillimisht e informoi Trupin Gjykses lidhur me këtë kërkesë, më 8 nëntor 2024, përmes postës elektronike. Më 14 nëntor 2024, Trupi Gjykses udhëzoi Mbrojtjen ta dorëzonte kërkesën në mënyrë zyrtare dhe udhëzoi mbrojtësin e viktimave të dorëzonte përgjigje, nëse dëshironte, deri më 19 nëntor 2024, *shih* CRSPD 179, *Postë elektronike nga Trupi Gjykses Drejtuar Palëve dhe Pjesëmarrësve për Mesazhin e Mbrojtjes lidhur me Urdhrin për Zhdëmtim*, datë 14 nëntor 2024, në orën 15:10.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00863, Mbrojtësi i Viktimave, *Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për të Liruar z. Shala nga Seanca për Shqiptimin e Urdhrit për Zhdëmtim, ose për Shtyrjen e Seancës*, 18 nëntor 2024, publike.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Trupi Gjykues mbështetet në nenet 21(4)(e), 22(3), (7) dhe (8) dhe 40(2) të Ligjit nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullën 68 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara (Rregullorja).

III. PARASHTRIMET

6. Mbrojtja kërkon nga Trupi Gjykues që të lirojë z. Shala nga seanca për shqiptimin e Urdhrit për Zhdëmtim, ose, si alternativë, të shtyjëseancën.⁵ Mbrojtja parashtron se z. Shala ka një vizitë të konfirmuar, të caktuar paraprakisht, me persona që do të udhëtojnë nga jashtë vendit për ta takuar në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, më 29 nëntor 2024.⁶ Mbrojtja përmend vështirësitë logjistike për riorganizimin e kësaj vizite dhe thekson se vizita e planifikuar për 29 nëntor 2024, është e vetmja vizitë personale që ka të planifikuar z. Shala për të ardhmen e parashikueshme.⁷ Sipas Mbrojtjes, takimi është një nga mundësitë e rralla për z. Shala që të ketë kontakt me botën e jashtme dhe, për rrjedhojë, është shumë i rëndësishëm për mirëqenien e z. Shala.⁸

7. Mbrojtësi i viktimave, pasi u konsultua me viktimat pjesëmarrëse, kërkon nga Trupi Gjykues të rrëzojë kërkesën e Mbrojtjes për shtyrjen e datës për shqiptimin e Urdhrit për Zhdëmtim.⁹ Mbrojtësi i viktimave mbështet mendimin e Trupit Gjykues nëse prania e z. Shala në seancë është e nevojshme apo jo, duke theksuar se prania e z. Shala është e parëndësishme për viktimat pjesëmarrëse.¹⁰

⁵ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 6, 11.

⁶ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 7-8.

⁷ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 8.

⁸ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 8.

⁹ Përgjigja e Mbrojtësit të viktimave, para. 9.

¹⁰ Përgjigja e Mbrojtësit të viktimave, para. 8.

IV. ANALIZË

A. PRANIA E Z. SHALA NË SALLËN E GJYQIT

8. Duke u mbështetur në rregullën 68(4)(e) të Rregullores, Trupi Gjykses është i mendimit se prania e z. Shala në sallën e gjyqit, në këtë rast konkret, kërkohet nga Ligji dhe Rregullorja, sikurse është njoftuar si dhe për arsyet e paraqitura në Urdhrin për Caktimin e Datës,¹¹ me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme që përlligjin mungesën e tij. Trupi Gjykses nuk është bindur nga parashtrimet e Mbrojtjes se vizitat e caktuara për z. Shala përbëjnë rrethana të jashtëzakonshme që do të përlligjin mungesën e tij në seancë. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses rrëzon kërkesën e z. Shala që të lejohet të heqë dorë nga e drejta për të marrë pjesë në seancë më 29 nëntor 2024.

B. SHTYRJA E SEANCËS

9. Në lidhje me kërkesën e Mbrojtjes për shtyrjen e datës së shqiptimit të Urdhrit për Zhdëmtim, Trupi Gjykses vëren se kjo shtyrje përlligjet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Në rastin konkret, Trupi Gjykses vlerëson se faza e zhdëmtimit është një hap i rëndësishëm për procesin, që lidhet si me z. Shala si zbatues të drejtpërdrejtë të Urdhrit për Zhdëmtim ashtu edhe me viktimat që kërkojnë zhdëmtim në këtë çështje. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses mban parasysh parashtrimet e mbrojtësit të viktimave se viktimat pjesëmarrëse kundërshtojnë fort shtyrjen e shqiptimit të Urdhrit për Zhdëmtim.¹² Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se vizitat në objektin e paraburgimit, të planifikuara, në vetvete, nuk përbëjnë rrethana të jashtëzakonshme për të shtyrë një seancë kaq të rëndësishme. Së fundi, duke mbajtur parasysh kohëzgjatjen e shkurtër të paraparë të seancës së 29 nëntorit 2024, udhëzohet Zyra Administrative të ndihmojë, sa më

¹¹ Urdhri për Caktimin e Datës, para. 4-6.

¹² Përgjigja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 7.

shumë që të jetë e mundshme, për organizimin e vizitave të z. Shala atë ditë. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses rrëzon kërkesën e z. Shala për të shtyrë datën e seancës.

V. VENDIM

10. Për arsyet e përmendura më sipër, Trupi Gjykses:

- a) **RRËZON** Kërkesën e Mbrojtjes;
- b) **PARASHTRON** se z. Shala duhet të jetë i pranishëm në sallën e gjyqit gjatë shqiptimit të Urdhrit për Zhdëmtim; dhe
- c) **UDHËZON** Zyrë Administrative të ndihmojë, sa më shumë që të jetë e mundshme, për vizitat që mund të ketë z. Shala më 29 nëntor 2024.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E premte, 22 nëntor 2024

Në Hagë, Holandë